

An aerial view of the deck of a red ship. The deck is equipped with several large spools of white cable, a worker in a white uniform and yellow hard hat, and various pieces of machinery. The ship is surrounded by deep blue water.

**KODI I SJELLJES
SË BIZNESIT IMSC-SË**



“ Ne përpiqemi t’u sigurojmë punonjësve tanë perspektiva për një karrierë afatgjatë në kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme. ”



MSC-ja është bërë një kompani lider në transportin detar ndërkombëtar duke ofruar një kujdes të jashtëzakonshëm për klientët tanë në mbarë botën. Ne e fitojmë besimin e tyre duke e drejtuar biznesin tonë në mënyrë të ligjshme, të përgjegjshme dhe me integritet.

Kodi i Sjelljes së Biznesit i MSC-së konfirmon parimet sipas të cilave e ushtron aktivitetin MSC-ja. Kodi vlen për të gjithë punonjësit e MSC-së në Zyrat tona Qendrore Globale, si dhe në të gjitha agjencitë tona në mbarë botën. Ai përcakton një standard të përbashkët për të gjitha operacionet globale të MSC-së kudo që ushtrojmë aktivitetin.

Duke zbatuar këtë Kod në punën tonë të përditshme, MSC-ja do të respektojë parimet tona etike dhe vlerat themelore të cilat qëndrojnë në themel të biznesit tonë.

Me respekt,

Diego Aponte

President dhe DPE i Grupit

TABELA E PËRMBAJTJES

KODI I SJELLJES SË BIZNESIT I MSC-SË

4 FJALORI

6 HYRJE

- 6 VLERAT THEMELORE TË MSC-SË
- 7 OBJEKTIVI I KODIT
- 8 QËLLIMI I KODIT
- 8 INTERPRETIMI I KODIT
- 9 RAPORTIMI I SJELLJES SË PAPËRSHTATSHME

10 STANDARDI I SJELLJES

11 MJEDISI

12 TË DREJTAT E NJERIUT DHE STANDARDET E PUNËS

- 12 MOSDISKRIMINIMI
- 13 RESPEKTI RECIPROK DHE TRAJTIMI I DREJTË
- 13 DIVERSITETI
- 13 NGACIMI DHE SJELLJET E TJERA ABUZIVE
- 13 LIRIA E ORGANIZIMIT
- 14 PUNA E DETYRUAR DHE SKLLAVËRIA MODERNE

- 14 PUNA E FËMIJËVE DHE MBROJTJA
E PUNONJËSVE TË MITUR
- 14 ANGAZHIMI I KOMUNITETIT DHE I PALËVE
TË INTERESUARA
- 14 MBËSHTETJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT
- 15 SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

16 NDALIMI I KORRUPSIONIT

17 KONFLIKTI I INTERESIT

18 RREGULLORET E SANKSIONEVE

18 PASTRIMI I PARAVE

19 LIGJET PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

20 DOKUMENTET FINANCIARE DHE TË BIZNESIT

20 KONTRATAT

21 INFORMACIONET KONFIDENCIALE, MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE PRIVATËSIA, DHE PAJISJET ELEKTRONIKE

- 21 INFORMACIONI KONFIDENCIAL
- 21 MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE PRIVATËSIA
- 21 PAJISJET ELEKTRONIKE

22 MEDIAT SOCIALE DHE LIGJËRIMI PUBLIK

- 22 PËRDORIMI I MEDIAVE SOCIALE PËR BIZNES
- 22 LIGJËRIMI PUBLIK DHE ANGAZHIMI NË MEDIA





FJALORI

Aty ku është e përshtatshme, fjalët në numrin njëjës do të përfshijnë edhe fjalët në numrin shumës dhe anasjelltas. Përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, një referim në gjininë mashkullore do të përfshijë edhe referimin në gjininë femërore.

A

Agjencia(të)

nënkupton (i) agjencitë e MSC-së në të gjithë botën kur veprojnë për MSC-në dhe në emër të saj dhe përfshin, sipas rastit, nënagjencinë(të) që vepron për MSC-në dhe në emër të saj, (ii) qendrat e planifikimit të MSC-së, (iii) zyrat e degëve të MSC-së, (iv) filialet e MSC-së dhe (v) kompanitë me të cilat MSC-ja ka lidhur marrëveshje për menaxhimin e anijeve: Mediterranean Shipping Company S.R.L., që ndodhet në Sorrento, Itali dhe MSC Shipmanagement limited, që ndodhet në Limasol, Qipro (përfshi çdo filial).

C

C-TPAT

nënkupton Partneritetin Doganor-Tregtar kundër Terrorizmit të krijuar nga Mbrojtja e Kufirit dhe Doganave të SHBA-së, që bën pjesë në Departamentin e Sigurisë Kombëtare të SHBA-së.

D

Dhuratat

nënkupton çdo gjë me vlerë në lidhje me biznesin e MSC-së dhe "Mikpritja e korporatës" nënkupton çdo eveniment që organizon MSC-ja ose Agjencitë ose në të cilën marrin pjesë Punonjësit për qëllime lidhur me biznesin. Shembujt e zakonshëm përfshijnë vaktet me qmime të arsyeshme, evente sportive, shfaqjet teatrale dhe aktivitete edukative për qëllime lidhur me biznesin.

I

Informacioni konfidencial

nënkupton të gjitha informacionet jopublike që zotëron MSC-ja ose agjencitë lidhur me biznesin, duke përfshirë pa kufizim, kontratat, informacionet e çmimeve, planet e marketingut, vëllimet tregtare, identitetet e klientëve, veprimet dhe specifikimet teknike të anijeve, sekretet tregtare dhe çdo informacion tjetër me vlerë tregtare për çdo person tjetër, të komunikuar me çdo mjet, përfshi verbalisht dhe/ose me mjete elektronike, pavarësisht nëse janë apo jo të shënuara, të përcaktuara ose të identifikuar ndryshe si "konfidenciale".

K

Kodi

nënkupton versionin më të fundit të Kodit të Sjelljes së Biznesit të MSC-së të publikuar në faqen e internetit të MSC-së.

Konflikti i interesit

nënkupton një situatë kur një Punonjës që bën biznes për dhe/ose në emër të MSC-së ka interesa private që mund të bien ndesh me interesat e MSC-së, në një mënyrë të tillë që krijon rrezik që vendimet e tij mund të ndikohen nga interesi privat ose mund të ndryshojnë në një mënyrë tjetër kryerjen e detyrave të tij në emër të MSC-së.

Korrupsioni

nënkupton veprimin e ofrimit, premtimit ose dhënies në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të një përfitimi të paligjshëm një nëpunësi shtetëror, në mënyrë që nëpunësi shtetëror të kryejë ose të mos kryejë një veprim në lidhje me aktivitetin e tij zyrtar, i cili është në kundërshtim me detyrën e tij ose që varet nga zgjedhja e tij.

M

Media sociale

nënkupton përdorimin privat ose personal të faqeve të internetit dhe aplikacioneve që përdoren për të komunikuar me përdoruesit e tjerë ose për të gjetur njerëz me interesa të ngjashme me ato të dikujt, duke përfshirë, pa kufizim, Facebook dhe LinkedIn.

Mediat sociale të MSC-së

nënkupton mediat sociale, por përveç tyre kudo ku një punonjës zbulon edhe statusin e tij si punonjës i MSC-së, qoftë drejtpërdrejt, si p.sh., duke bërë një deklaratë ose përmendje të MSC-së, qoftë tërthorazi, si p.sh., duke ngarkuar një fotografi që identifikon MSC-në, për shembull me logon e MSC-së në sfond.

MSC

nënkupton MSC Mediterranean Shipping Company SA, që ndodhet në 12-14 Chemin Rieu, 1208 Geneva, Zvicër.

N

Nëpunësi shtetëror

nënkupton një person: (i) që shërben, është i punësuar ose vepron si agjent i cilësdo agjencie ose entiteti kombëtar, shtetëror ose të qeverisjes lokale të çdo vendi; (ii) që shërben, është i punësuar ose vepron si agjent i cilësdo organizate ndërkombëtarepublike (të tillë si Banka Botërore ose Kombet e Bashkuara); (iii) që punon në cilëndo ndërmarrje tregtare në pronësi të qeverisë ose të kontrolluar prej saj; (iv) që punon në një parti politike; (v) që po kandidon për një post politik.

P

Pagesa Favorizuese

nënkupton të gjitha pagesat ose përfitimet e çdo lloji që bëhen me qëllim përshpejtimin ose lehtësimin e kryerjes nga një nëpunës shtetëror të një veprimi të zakonshëm qeveritar.

Pajisja(et) elektronike

nënkupton çdo pajisje elektronike që dedikohet kryesisht për komunikimin, përpunimin dhe transferimin e informacioneve (të cilat mund të përfshijnë informacionet konfidenciale dhe të dhënat personale) në një mjedis profesional. Këto pajisje përfshijnë, por jo vetëm, kompjuterët laptop, kompjuterët desktop, serverët, telefonat celularë, tabletët, kartat SIM të pajisjeve celulare, pajisjet ruajtëse të heqshme ose statike, si dhe çdo softuer të instaluar ose të ruajtur në këto pajisje.

Punonjësi(t)

nënkupton punonjësit, përfaqësuesit, nëpunësit dhe drejtorët e MSC-së dhe të Agjencie.

R

Korrupsioni aktiv

nënkupton çdo veprim për t'i ofruar, premtuar ose dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë cilitdo personi në sektorin privat një përfitim të paligjshëm, në mënyrë që personi të kryejë ose të mos kryejë një veprim në lidhje me aktivitetin e tij profesional ose tregtar, i cili është në kundërshtim me detyrën e tij ose që varet nga zgjedhja e tij.

Korrupsioni pasiv

nënkupton veprimin e një Punonjësi, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për të kërkuar, pranuar ose marrë një përfitim të paligjshëm për përfitimin e tij personal ose për përfitimin e një personi të tretë për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi në lidhje me aktivitetin e tij profesional ose tregtar, i cili është në kundërshtim me detyrën e tij ose që varet nga zgjedhja e tij.

S

Sjellja e papërshtatshme

nënkupton çdo sjellje të paligjshme ose të papërshtatshme që kryhet nga një Punonjës, përfshi një shkelje të Kodit.

T

Të dhënat personale

nënkupton çdo informacion ose të dhënë që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm. Të dhëna personale janë çdo pjesë informacioni që lidhet me një person të tillë, pavarësisht nga forma me të cilën është shprehur dhe nga formati i informacionit (pajisje ruajtëse, letër, kasetë, film, media elektronike etj.). Për qëllimin e këtij Kodi, entitetet ligjore do të përfshihen nga objekti i tij, përveçse nëse parashikohet ndryshe nga ligji lokal për mbrojtjen e të dhënave. Të dhënat personale përfshijnë çdo informacion që lidhet me një person të identifikueshëm. Ekzistojnë mënyra të ndryshme sipas të cilave një person mund të konsiderohet "i identifikueshëm". Emri dhe mbiemri i një personi është një identifikues i drejtpërdrejtë. Edhe informacionet e tjera të kombinuara mund të jenë të mjaftueshme për të identifikuar një person. Të dhënat personale mund të lidhen sidomos, por jo vetëm, me emrin, datën e lindjes, adresën; adresën e emailit dhe numrin e telefonit personal dhe profesional, pavarësisht nëse përdoret për qëllime personale ose profesionale; përshkrimin e ngarkesës të shoqëruar me emrin ose detajet e kontaktit të palëve në kontratën e ngarkesës; gjeolokalizimin e kontejnerëve të klientëve; detajet profesionale, titullin e punës, numrin e kartelës identifikuese të punonjësve; detajet e kontaktit të klientëve ose detajet financiare të klientëve ose çdo informacion tjetër të nevojshëm për kontrollin e kreditit; adresën IP ose numrin e serisë së një pajisjeje.

Z

Zbatuesi i Kodit

nënkupton personin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Sjelljes së Biznesit të MSC-së në një Agjenci.

HYRJË

VLERAT THEMELORE TË MSC-SË

Vlerat themelore të MSC-së përbëjnë gurët e themelit të kompanisë. Ato mbështesin vizionin e MSC-së, i japin formë kulturës së MSC-së dhe përcaktojnë drejtimin e ardhshëm të MSC-së. Këto vlera themelore duhet të udhëheqin edhe sjelljen e të gjithë punonjësve në ndërveprimet e tyre me njëri-tjetrin.



NE JEMI NJË KOMPANI FAMILJARE

Përkushtimi i Familjes themeluese na frymëzon me dedikimin dhe besimin, duke na rritur ndjesinë e përkatësisë. Shpirti ynë sipërmarrës i njëjtë me Familjen bën që të veprojmë në mënyrë proaktive, me guxim dhe me përgjegjësi në interesin më të mirë të klientëve tanë dhe të kompanisë sonë.



NE KEMI PASION

Ne e kemi pasion atë që bëjmë, e sfidojmë veten për të arritur përsosmërinë dhe i kalojmë pengesat me këmbëngulje. Duke punuar së bashku me pasion dhe entuziazëm, ne ofrojmë një eksperiencë unike për klientët tanë.



NE JEMI NË EVOLUCION TË VAZHDUESHËM

Tradita, ekspertiza, profesionalizmi dhe ambicia jonë nxisin rritjen e shpejtë dhe të qëndrueshme të kompanisë. Ne përpiqemi për zgjidhjet më inovative për të përkrahur ndryshimin, duke respektuar gjithnjë sigurinë dhe mjedisin.



NE KUJDESEMI PËR NJERËZIT

Ne besojmë se çdo person sjell një vlerë unike. Ne zhvillojmë marrëdhënie autentike të ndërtuara mbi etikën, respektin dhe shpirtin e skuadrës. Ne i kushtojmë me të vërtetë vëmendje kënaqësisë dhe besnikërisë së klientëve dhe punonjësve tanë.



NE BESOJMË NË MUNDËSITË E BARABARTA

Misioni ynë është t'u sigurojmë njerëzve tanë realizimin dhe pasurimin personal. Ne jemi të përkushtuar për të ndarë njohuritë tona me anë të trajnimeve dhe mbështetjes për të mundësuar rritjen profesionale të njerëzve tanë. Ne garantojmë mundësi të drejta duke ofruar zhvillimin e karrierës afatgjatë, duke përkrahur diversitetin dhe duke vlerësuar të gjitha kulturat.

OBJEKTIVI I KODIT

Duke qenë një kompani globale lider në transportin detar, MSC-ja e fiton reputacionin dhe besimin e saj çdo ditë, duke ofruar shërbime të pakrahasueshme për klientët e saj dhe duke e ushtruar aktivitetin në mënyrë të drejtë dhe etike. Reputacioni ynë për besimin dhe integritetin çdo ditë, në veprimet e çdo punonjësi.

Kodi plotëson dhe duhet të lexohet në lidhje me politikat dhe procedurat e tjera që mund të miratojë MSC-ja me qëllim zbatimin e parimeve të Kodit, si dhe të politikave të tjera.

MSC-ja rezervon gjithashtu të drejtën ta ndryshojë herë pas here Kodin. Punonjësit duhet të informohen dhe të jenë në dijeni për çdo përditësim. Versioni më i fundit i Kodit mund të gjendet në faqen e internetit të MSC-së.

Punonjësit janë të lirë të dërgojnë çdo pyetje mbi Kodin dhe zbatimin e tij në ethic@msc.com.



QËLLIMI I KODIT

Kodi është një udhëzues për të ndihmuar Punonjësit dhe Agjencitë të ushtrojnë biznese me etikë. Zbatimi i këtij Kodi është përparësia kryesore për MSC-në dhe MSC-ja pret nga Punonjësit dhe Agjencitë t'i përmbahen atij. MSC-ja rezervon të drejtën për të kryer auditime të brendshme për të garantuar pajtueshmërinë e punonjësve dhe agjencive me standardet e përcaktuara në Kod me ndihmën e Departamentit të Auditimit të Korporatës MSC në Gjenevë dhe të departamenteve të tjera ose audituesve të jashtëm, sipas rastit. MSC-ja i inkurajon agjencitë e saj ta plotësojnë këtë Kod duke miratuar dhe zbatuar parime dhe politika të tjera përveç atyre që përmban ky Kod. Megjithatë, në asnjë rast ato parime dhe politika shtesë nuk duhet të jenë në konflikt me Kodin ose më lehtësuese se ai. Të gjitha parimet dhe politikat shtesë do t'i dërgohen Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë për t'i rishikuar dhe miratuar. Kur ekzistojnë ndryshime si pasojë e ligjeve ose rregulloreve vendore, duhet të zbatohet ose Kodi, parimet dhe politikat shtesë, ose kërkesat vendore, cilado vendos standardin më të lartë etik.

Çdo punonjës është përgjegjës dhe jep llogari për:

- Kuptimin dhe plotësimin e standardeve të përshkruara në këtë Kod;
- Të qenët i informuar dhe në dijeni të çdo përditësimi; dhe
- Kryerjen e kurseve përkatëse të trajnimit me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe të të kuptuarit të standardeve të përmendura në këtë Kod.

Megjithatë, përgjegjësitë shtesë i takojnë çdo Punonjësi i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e të tjerëve:

- Për të qenë një shembull duke vepruar në përpikmëri, në përputhje me formën dhe përmbajtjen e Kodit;
- Për t'u siguruar që të gjithë Punonjësit nën mbikëqyrjen e tij janë vënë në dijeni dhe janë trajnuar për mënyrën e zbatimit të Kodit;
- Për të mbikëqyruar dhe monitoruar zbatimin nga stafi i tij të parimeve të përcaktuara në Kod; dhe

Për të ndaluar çdo sjellje që shkel Kodin dhe për t'ia raportuar sjelljen Zbatuesit të Kodit, i cili duhet ta raportojë sjelljen tek Ekipi i Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë. Punonjësit që punojnë në Gjenevë, Zvicër, duhet ta raportojnë drejtpërdrejt tek Ekipi i Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë.

INTERPRETIMI I KODIT

Kodi nuk ka për qëllim të parashikojë të gjitha rrethanat apo situatat që mund të lindin. Në fakt, ai përcakton parimet dhe politikat për ushtrimin e aktivitetit të MSC-së në një mënyrë etike. Kur ndeshen me situata që nuk trajtohen në mënyrë specifike nga ky Kod, Punonjësit duhet të ruajnë standardet më të larta etike të vërejtura në industri. Situatat që nuk parashikohen në Kod duhet t'i referohen Zbatuesit të Pajtueshmërisë, i cili duhet t'ia raportojë Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë. Punonjësit që punojnë në Gjenevë, Zvicër, duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë.

Nëse një Punonjës nuk është i sigurt nëse sjellja e tij do të ishte kundërshtim me Kodin, duhet t'i bëjë vetes disa pyetje të thjeshta:

- A është ky veprim i ligjshëm dhe në pajtim me Kodin?
- A do të ishte e padëmshme për MSC-në ose për mua nëse kjo sjellje bëhet e ditur?
- A do të doja që veprimet e mia të publikohen në faqen e parë të një gazete?
- A do të doja që dikush të vepronte në të njëjtën mënyrë ndaj meje?

Nëse përgjigjja ndaj cilësdo prej këtyre pyetjeve është "jo", veprimi konsiderohet se nuk është në përputhje me Kodin dhe nuk duhet të kryhet. Nëse përsëri nuk jeni të sigurt për përgjigjen, duhet të kontaktoni Zbatuesin e Kodit. Nëse çështja nuk mund të zgjidhet nga Zbatuesi i Kodit, ky i fundit duhet të konsultohet me Ekipin e Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë. Punonjësit që punojnë në Gjenevë, Zvicër, duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë. Detajet e kontaktit të Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë për çdo pyetje lidhur me Kodin mund t'i gjeni në intranetin e MSC-së. Punonjësit janë të lirë të dërgojnë çdo pyetje në adresën ethic@msc.com.

RAPORTIMI I SJELLJES SË PAPËRSHTATSHME

Sjellja e papërshtatshme përfshin, por jo vetëm, korrupsionin, shpërdorimin e detyrës, rryshfetin, vjedhjen ose keqpërdorimin e pronës së MSC-së, mashtrimin, shtrëngimin, çdo keqbërje, moskryerjen e qëllimshme të një detyre ose shkeljen e Kodit ose të cilësdo politikë dhe procedurë të MSC-së.

Në përputhje me vlerat themelore të MSC-së, aftësia për të shprehur mendimin është themeli për të ndërtuar një kulturë të hapur dhe të përgjegjshme në vendin e punës. Punonjësit kanë në dispozicion një modul online që quhet "MSC's Speak-Up Line" ku mund të hyni nëpërmjet intranetit të MSC-së për të raportuar çdo sjellje të papërshtatshme në çdo kohë.

Çdo sjellje e papërshtatshme duhet të raportohet menjëherë. Punonjësit inkurajohen fort të përdorin aplikacionin "MSC's Speak-Up Line" dhe si alternativë, t'i raportojnë Zbatuesit të Kodit ose Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë, sipas rastiit përkatës. Nëse raportimi i sjelljes së papërshtatshme krijon konflikt interesi për Zbatuesin e Kodit, çështja duhet t'i dërgohet Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë ose në "MSC's Speak Up Line". Punonjësit që punojnë në Gjenevë, Zvicër, duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë ose MSC's Speak Up Line.

Kur raportojnë sjelljen e papërshtatshme, Punonjësit mund të zgjedhin të identifikohen ose të mbeten anonimë në përputhje me ligjet në fuqi. Nuk do të ketë asnjë masë ndëshkuese ndaj asnjë Punonjësi që bën një raportim në mirëbesim.

MSC-ja i merr shumë seriozisht shkeljet e dyshuara dhe do të hetojë me drejtësi çdo dëshmi. Çdo mosrespektim i Kodit mund të çojë në veprime disiplinore deri në zgjidhjen e Kontratës së Punës ose të çdo kontrate tjetër, si dhe duke përfshirë, dënime të mundshme civile ose penale.





STANDARDI I SJELLJES

MSC-ja është një kompani që ofron shërbime botërore për kontejnerë në një rrjet me 200 linja tregtare, të organizuara në mbi 340 porte për kontejnerë. Në sajë të pranisë ndërkombëtare të konsoliduar dhe gjithnjë në rritje të MSC-së, të gjithë Punonjësit duhet të respektojnë të gjitha ligjet, rregulloret dhe rregullat në fuqi, udhëzimet zyrtare, kodet e praktikës më të mirë, partneritetet me qeveritë dhe standardet e ISO-s, sipas rastit.


Përveç këtyre, Kodi përcakton standardin e zakonshëm të sjelljes së lejuar, pavarësisht nga vendndodhja e Punonjësit. Këto standarde plotësojnë dhe mund të shkojnë përtej përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në shumë vende ku vepron MSC-ja.


MJEDISI

MSC-ja kërkon të jetë lider në transportin detar miqësor ndaj mjedisit. Për këtë qëllim, MSC është e përkushtuar për:

- Zvogëlimin e ndikimit në ndryshimin klimatik duke punuar vazhdimisht për të minimizuar emetimin e gazit serrë, për shembull duke përdorur MSC Eco Toolbox, i cili mat përdorimin e energjisë dhe konsumin e karburantit nga anijet;
- Mbrojtjen e diversitetit biologjik dhe të jetës nënujore, për shembull duke kërkuar që trupat e anijeve të ndërtuara rishtazi që vijjnë në shërbim të MSC-së të lyhen me veshje të përshtatshme për mjedisin;
- Investimin në teknologjitë inovative për të zvogëluar gjurmën mjedisore të shërbimeve tona, për shembull në optimizimin e konstruksionit të trupit të anijeve të ndërtuara rishtazi për të përmirësuar efikasitetin e karburantit dhe për t'i zbatuar këto teknologji për përmirësimin e anijeve ekzistuese;
- Zbatimin e sistemeve operative dhe të menaxhimit, përfshi nëpërmjet dixhitalizimit dhe inxhinierimit të proceseve, për të rritur në maksimum efikasitetin dhe për të shmangur gabimin njerëzor, për shembull duke përdorur Sistemin e Shkëmbimit të Planifikimit Inteligent - IPX, i cili planifikon dhe mbush automatikisht ngarkesat e rrezikshme;
- Inkurajimin e projekteve të riciklimit në MSC dhe Agjenci, për shembull duke ricikluar letrën, shishet plastike, pajisjet e TI-së dhe tonerin e bojës.

Çdo Punonjës duhet të jetë mendjehapur për risinë dhe ndryshimin. Menaxherët inkurajohen të dëgjojnë idetë e Punonjësve për mënyrën se si të zvogëlohet konsumi i burimeve.





TË DREJTAT E NJERIUT DHE STANDARDET E PUNËS

MSC-ja mbështet dhe përpiqet për të përmirësuar vazhdimisht qeverisjen e mirë të korporatës që kontribuon në qëllimet për përgjegjësinë sociale dhe për zhvillimin e qëndrueshëm më të gjerë siç pritet nga komuniteti ndërkombëtar. Për ta arritur këtë, MSC-ja respekton minimalisht të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi të vendeve ku vepron. Përveç kësaj, MSC-ja është pjesë e sektorit të transportit detar ndërkombëtar, i cili është një prej industrive më të rregulluara në nivel botëror, prandaj përkushtimi i saj për të promovuar praktikat e përgjegjshme dhe të drejta të biznesit i përmbahet dhe mbështetet në parimet dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut dhe punën.

Në këtë aspekt dhe në përputhje me vlerat themelore të MSC-së, me qasjen sipas parimeve të Konventës Botërore të Kombeve të Bashkuara, si dhe me Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (PUKB), MSC-ja mbështet respektimin e parimeve përkatëse siç parashikohen në Kartën Ndërkombëtare Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, si dhe respektimin e dispozitave dhe rekomandimeve përkatëse të instrumenteve dhe konventave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP). Duke qenë një kompani për transportin detar ndërkombëtar, MSC-ja respekton gjithashtu një gamë të gjerë kërkesash dhe standardesh ndërkombëtare të përcaktuara nga konventat detare dhe ato të punës, të miratuara në nivel ndërkombëtar nga Kombet e Bashkuara, përfshi Konventën për Punën Detare të ONP-së, 2006 (KPD, 2006).

MOSDISKRIMINIMI

Në përputhje me vlerat e saj themelore, MSC-ja është shumë e përkushtuar për të mbështetur mundësitë e barabarta të punësimit, duke garantuar që të gjitha aspektet e marrjes në punë dhe të punësimit të bazohen në meritë dhe në aftësitë në punë.

MSC-ja respekton veçantinë e çdo personi dhe nuk e toleron diskriminimin e bazuar në cilindo motiv, si p.sh., gjinia, raca, ngjyra, besimi, gjuha, origjina etnike, mosha, aftësia e kufizuar, përkatësia politike ose ideologjike, anëtarësia në sindikatë, gjendja civile ose përgjegjësitë familjare, orientimi seksual ose identiteti gjinor. Vëmendje e veçantë i kushtohet kategorive vulnerabelë të punëtorëve siç pritet nga komuniteti ndërkombëtar.

MSC-ja dhe Agjencitë veprojnë në përputhje me ligjet kombëtare në fuqi kërkesat lokale dhe/ose standardet përkatëse ekzistuese të industrisë lokale që respektojnë dhe garantojnë minimumi të drejtat e punonjësve të saj në të gjitha aspektet e punësimit. Këtu përfshihen aplikimet për punësim, ngritjet në detyrë, shpërblimet, pagat, puna jashtë orarit, orari i punës, leja, përfitimet, qasja në trajnim, caktimi i punës, përfitimet sociale, masat korrigjuese dhe disiplinore, ndërprerja e punësimit ose dalja në pension.



RESPEKTI RECIPROK DHE TRAJTIMI I DREJTË

MSC-ja beson se çdo person, përfshi klientët, partnerët e biznesit dhe të gjitha palët e interesuara me të cilat ndërveprojmë, meritojnë të trajtohen me respekt, drejtësi dhe dinjitet.

Kjo përgjegjësi i takon çdo Punonjësi.

DIVERSITETI

Shumëllojshmëria e Punonjësve përbën një prej pasurive më të mëdha të MSC-së dhe kontribuon në suksesin e saj të vazhdueshëm.

MSC-ja pret nga Punonjësit e saj të vlerësojnë aftësitë, pikat e forta dhe zotësitë unike të çdo personi dhe të mbështesin njëri-tjetrin duke përkrahur dhe respektuar diversitetin kulturor dhe traditat vendase.

NGACMIMI DHE SJELLJET E TJERA ABUZIVE

MSC-ja nuk toleron asnjë formë ngacmimi ose sjelljeje abuzive, përfshi presionin verbal ose mendor, ndëshkimin fizik dhe ngacmimin seksual. Ngacmimi dhe sjellja abuzive mund të përfshijnë veprime ose kërcënime për dhunë ndaj një personi tjetër (përfshi gjestet, bulizmin, "shakatë" ose kanosjen, gjuhën dhe kontaktin fizik), si dhe dëmtimin e qëllimshëm të pronës së MSC-së dhe Agjencive ose të pronës së një personi tjetër, ose çdo sjellje tjetër që i bën të tjerët të ndjehen të pasigurt në vendet e punës të MSC-së ose Agjencive.

LIRIA E ORGANIZIMIT

MSC-ja njej lirinë e organizimit për të gjithë Punonjësit. Të gjithë Punonjësit do të kenë të drejtën të bashkohen ose të mos bashkohen dhe të formojnë sindikata pa frikën e kanosjes ose të masave ndëshkimore, në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

PUNA E DETYRUAR DHE SKLLAVËRIA MODERNE

MSC-ja është e përkushtuar të garantojë respektimin e dinjitetit njerëzor themelor për të gjithë Punonjësit e saj.

Për këtë qëllim, MSC-ja ndalon shfrytëzimin ekonomik dhe social të një personi nga një person tjetër për fitim personal dhe/ose tregtar, punën e detyruar/pa vullnet të lirë sipas përcaktimit në Konventën për Punën e Detyruar CO29 të ONP-së, 1939 (Nr. 29), punën e të burgosurve dhe çdo formë të skllavërisë ose robërisë, përfshi punën në varësi të plotë dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

PUNA E FËMIJËVE DHE MBROJTJA E PUNONJËSVE TË MITUR

MSC-ja ndalon rreptësisht punën e fëmijëve dhe i përmbahet standardeve përkatëse ndërkombëtare lidhur me të drejtat e fëmijëve, të tilla si Konventa për Moshën Minimale C138 e ONP-së, 1973 (Nr. 138), Konventa për Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve C182 e ONP-së, 1999 (Nr. 182) dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF).

Kur shfaqen konflikte ose ndryshime në standarde, MSC-ja zbaton standartet më të larta. MSC-ja mbështet dhe investon në programet e trajnimit në pjesë të ndryshme të botës për të përdorur potencialin e të rinjve. Në përputhje me Deklaratën Tripalëshe të ONP-së për Parimet lidhur me Ndërmarrjet Shumëkombëshe dhe Politikën Sociale (Deklarata mbi NSHK-të, botimi i 5-të, 2017), për ofrimin e mundësive të tilla, MSC-ja vepron në pajtim me ligjet, rregulloret dhe kërkesat kombëtare në fuqi, duke garantuar respektimin e të drejtave të fëmijëve për të ndjekur dhe/ose për të përfunduar shkollimin e detyruar.

Duke qenë një kompani transporti detar ndërkombëtar, për detarët, MSC-ja i përmbahet dispozitave përkatëse të përfshira në Konventat e ILO-s në fuqi, përfshi Konventën për Punën Detare të ONP-së, 2006 (KPD, 2006).

ANGAZHIMI I KOMUNITETIT DHE I PALËVE TË INTERESUARA

MSC-ja e ka ndërtuar reputacionin e saj duke krijuar dhe ruajtur marrëdhënie të të gjitha niveleve me klientët e saj, partnerët e biznesit, komunitetet lokale dhe gamën e saj të gjerë të palëve të interesuara në bazë të vlerave të përbashkëta, besnikërisë dhe besimit reciprok.

Me qëllim për të kontribuar në ndikimet afatgjata pozitive sociale dhe ekonomike gjithëpërfshirëse, MSC-ja është shumë e përkushtuar për të ushtruar një aktivitet të përgjegjshëm që respekton të drejtat themelore të komuniteteve lokale, përfshi ato të personave vendës, si dhe të personave në grupet e tjera të vulnerabël dhe të disavantazuara.

MBËSHTETJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

MSC-ja i inkurajon Punonjësit që të kontribuojnë në praktikat e përgjegjësive sociale që mund të çojnë përpara realizimin e të drejtave të njeriut, kur gjykohen të përshtatshme dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe/ose planet e zhvillimit kombëtar, nëpërmjet:

- iniciativave dhe filantropisë në shkallë vendi ose rajoni
- angazhimit dhe përkrahjes së politikave publike
- partneriteteve dhe veprimeve kolektive

Kontributet e MSC-së në përpjekjet për të konsoliduar paqen dhe veprimet për ndihmat humanitare, përfshirë nëpërmjet veprimtarive themelore të biznesit, i përmbahen dhe respektojnë rregulloret ndërkombëtare përkatëse.

SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

MSC-ja përpiqet t'u ofrojë Punonjësve një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Për ta përmbushur këtë qëllim, MSC-ja:

- Respekton të gjitha ligjet për shëndetin dhe sigurinë, përfshi Konventën për Punën Detare 2006;
- Zbaton procedurat e sigurisë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë;
- Ka procedura të rrepta për transportimin e ngarkesave të rrezikshme. MSC-ja shkon përtej procedurave të vendosura në Kodin Ndërkombëtar Detar për Mallrat e Rrezikshme, dhe për disa mallra të rrezikshme ajo kërkon që ngarkesën ta kontrollojë një inspektor i pavarur; dhe
- Krijon partneritet me qeveritë për të rritur sigurinë e zinxhirit furnizues, për shembull, MSC-ja respekton standardet e C-TPAT-it.

Në përgjithësi, në det, pronari i anijes është kryesisht përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë e të gjithë detarëve. Megjithatë, përgjegjësia e përditshme i përket në përgjithësi kapitenit të anijes. Edhe Punonjësit kanë përgjegjësi: ata duhet të respektojnë masat e parashikuara për shëndetin dhe sigurinë në punë. Në tokë, ashtu si në det, ndahet edhe përgjegjësia për shëndetin dhe sigurinë. Masat për shëndetin dhe sigurinë janë vendosur brenda MSC-së dhe Agjencive; të gjithë Punonjësit duhet t'i zbatojnë.

Por është e rëndësishme të përforcohet se çdo Punonjës është përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë personale. Prandaj, çdo Punonjës gëzon të drejtën të largohet nga situatat ose punët e rrezikshme kur ekziston një rrezik i pashmangshëm dhe serioz për shëndetin ose sigurinë.

Në përpjekjen e saj për të përmirësuar vazhdimisht performancën për shëndetin dhe sigurinë në operacionet e saj, MSC-ja kryen hetime të aksidenteve dhe të atyre të mbetura në tentativë, sa herë që kërkohet nga procedurat tona të brendshme.



NDALIMI I KORRUPSIONIT

Ndërsa ushtron biznesin kudo në botë, MSC-ja është e përkushtuar për ta ushtruar biznesin në mënyrë të drejtë dhe për të mbështetur të gjitha ligjet kundër korrupsionit në fuqi, përfshi Kodin Penal të Zvicrës dhe, sipas rastit, Aktin e Praktikave të Korrupsionit të Huaj të SHBA-së dhe Ligjin e MB-së Kundër Korrupsionit 2010.

MSC-ja ndalon rreptësisht korrupsionin, korrupsionin aktiv dhe pasiv dhe Pagesat Favorizuese. Në shumicën e legjislacioneve, një sjellje e tillë mund të çojë në burgosjen e individëve dhe në gjoba të rënda për individët dhe subjektet. MSC-ja rezervon të drejtën të ndërmarrë masa disiplinore ndaj çdo Punonjësi të përfshirë në një sjellje të tillë. Punonjësit nuk duhet të përfshihen në një sjellje të tillë. Punonjësit nuk duhet të angazhohen një agjent, këshillues ose furnitor të tretë nëse ekziston arsyeja për të besuar se agjenti, këshilluesi ose furnitori mund të përpiqet të shkelë Politikën e MSC-së Kundër Korrupsionit.

Nëse Punonjësu u kërkohet të marrin Pagesa Favorizuese, ata duhet ta refuzojnë pagesën në mënyrë aktive dhe të informojnë menjëherë zbatuesin e tyre të Kodit dhe/ose Ekipin e Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë, sipas rastit. Fakti që pagesa u propozua fillimisht nga pala tjetër nuk e bën sjelljen të ligjshme. MSC-ja ka një politikë të tolerancës zero lidhur me Pagesat Favorizuese, përveçse kur është në rrezik shëndeti dhe siguria e një Punonjësi.

Ndonëse Dhuratat për Nëpunësit Shtetërorë lejohen, është shumë e lehtë ta kalosh kufirin nga Dhuratat me vlerë modeste dhe mikpritja e korporatës, në korrupsion. Dhuratat me vlerë modeste, të cilat lejohen sipas politikës së MSC-së, përfshijnë çdo dhuratë promovionale të MSC-së. MSC-ja nuk do ta tolerojë pagesën e rryshfeteve ndaj Nëpunësve Shtetërorë, përfshi ato që maskohen si dhurata.

Çdo Dhuratë dhe Mikpritje e Korporatës që merret ose jepet nga cilido Punonjës duhet të raportohet dhe të regjistrohet siç duhet. Çdo Dhuratë ose Mikpritje e Korporatës që merret ose jepet, vlera e të cilës e kalon kufirin e vendosur nga procedura e MSC-së për Dhuratat dhe Mikpritjen e Korporatës, siç zbatohet, është objekt i miratimit të Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë.



KONFLIKTI I INTERESIT


Konflikti i interesit mund të lindë, për shembull, kur një Punonjës përfshihet në një transaksion biznesi me një palë të tretë (duke përfshirë, pa kufizim, një dërgues navloje, një ndërmjetës dhe një operator jo i anijes), për të cillin Punonjësi ose një anëtar i familjes ka interes financiar ose personal (për shembull, si pronar, aksionar, anëtar bordi, nëpunës, punonjës ose agjent).

Asnjë Punonjës nuk duhet të përfshihet në asnjë aktivitet që mund të jetë në konflikt ose të ndryshojë gjykimin e tij për kryerjen e detyrave të tij.

Politika e MSC-së për Konfliktin e Interesit jep udhëzime për mënyrën e identifikimit, raportimit dhe menaxhimit të situatave ekzistuese ose të mundshme të konfliktit të interesit. Të gjithë Punonjësve u kërkohet të lexojnë me kujdes dhe të respektojnë rreptësisht Politikën E MSC-së për Konfliktin e Interesit, e cila përmban detyrimet për raportim për të gjithë Punonjësit.

Të gjithë Punonjësve u kërkohet të raportojnë çdo Konflikt Interesi ekzistues ose të mundshëm, duke plotësuar dhe dërguar Pyetësin për Konfliktin e Interesit sipas udhëzimeve të përcaktuara në Politikën e MSC-së për Konfliktet e Interesit. Edhe Punonjësit që nuk kanë asnjë Konflikt Interesi për të raportuar duhet ta plotësojnë dhe ta dërgojnë Pyetësin për Konflikt Interesi. Përveç kësaj, Punonjësit janë përgjegjës për përditësimin e informacionit të raportuar, për të siguruar që një raportim i tillë të jetë gjithmonë i saktë dhe i vërtetë.

Sa herë që rrethanat shkaktojnë një Konflikt Interesi të tillë ose edhe kur duket si i tillë, ai Punonjës duhet të marrë autorizim të veçantë me shkrim para se të marrë pjesë në një aktivitet ku ka të ngjarë që paanësia e tij të vihet në dyshim. Nëse Konflikti i Interesit lidhet me një vlerë të konsiderueshme të biznesit për MSC-në, ai duhet qartësuar nga Drejtuesit përkatës dhe, kur ka dyshime, nga Drejtuesit e Lartë të MSC-së.



RREGULLORET E SANKSIONEVE

Sanksionet janë ndalime për mospërfshirjen në transaksionet e specifikuar ndërkombëtare ku përfshihen individë, subjekte, ngarkesa, shtete ose anije të caktuara, për të arritur një objektiv kombëtar për sigurinë/ politikën.

Pajtueshmëria me sanksionet e Zvicrës dhe Bashkimit Evropian është në themel të modelit të biznesit të MSC-së. Prandaj, të gjithë Punonjësit dhe Agjencitë duhet të pajtohen me to, pavarësisht nga tregtia ose malli i transportuar.


MSC-ja ka zhvilluar dhe zbatuar një program për pajtueshmërinë e sanksioneve që përbëhet nga një grup procedurash për të siguruar pajtueshmërinë me të gjitha ligjet e sanksioneve në fuqi, i cili fokusohet jo vetëm te ngarkesa (përfshi kursin) dhe palët e kontratës së transportit, por edhe te anijet (përfshi pronësinë dhe kursin) dhe furnitorët e MSC-së. Janë krijuar programe të dedikuara trajnimi dhe pajisje të TI-së për të trajnuar Punonjësit dhe për të zbatuar programin e MSC-së për pajtueshmërinë e sanksioneve.

PASTRIMI I PARAVE

Pastrimi i parave ndodh kur një person kryen një veprim që ka për qëllim pengimin e identifikimit të origjinës, gjurmimit ose konfiskimit të pasurive që ai i di ose duhet të supozojë se e kanë origjinën nga vepër penale.

Agjencitë dhe Punonjësit ndalohen rreptësisht të marrin pjesë në një transaksion pastrimi parash ose ta favorizojnë atë.

Agjencitë dhe Punonjësit duhet të ushtrojnë vetëm aktivitete të ligjshme biznesi dhe nuk duhet të pranojnë ose të përdorin para ose pasuri të tjera për të cilat kanë arsye të dyshojnë se janë produkt i veprës penale.



LIGJET PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

MSC-ja ka një politikë të rreptë për respektimin e rregulloreve në fuqi për konkurrencën (që njihen edhe si “Ligjet për Mbrojtjen e Konkurrencës.”) në çdo kohë, pavarësisht nga vendndodhja. Manuali i Pajtueshmërisë me Ligjet e Konkurrencës i MSC-së duhet të zbatohet nga të gjithë Punonjësit dhe Agjencitë.

Shkeljet e Ligjeve për Mbrojtjen e Konkurrencës dënohen rreptësisht me ligj, përfshi në shumë vende me sanksione penale.

Agjencitë dhe Punonjësit që marrin një kërkesë për informacion nga një autoritet publik, përfshi hetimet dhe auditet shtetërore, duhet të informojnë menjëherë Ekipin e Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë.

Në rastin e një “vizite të papritur” ose inspektimi të palajmëruar, të filluar nga një autoritet i konkurrencës, Ekipi i Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë duhet të kontaktohet menjëherë (për udhëzime të mëtejshme rreth kësaj çështjeje, shikoni “Udhëzimet për vizitat e papritura të autoritetit të konkurrencës” që gjendet në intranetin e MSC-së).

Një fushë kryesore e sjelljes së paligjshme janë marrëveshjet me bizneset e tjera që kanë si qëllim të frenojnë konkurrencën (“marrëveshja e fshehtë”). Këtu përfshihet, për shembull, marrëveshja e fshehtë me një konkurrent lidhur me:

- Marrëveshjet lidhur me çdo element të çmimit, për shembull tarifën, uljet e çmimeve, rritjet e çmimeve, afatet e pagesave, që njihen si “fiksimi i çmimit”;
- Marrëveshjet që ndikojnë në mënyrën se si e shpërndan secila palë kapacitetin e saj, përfshi marrëveshjet e racionalizimit, kapacitetet në shfrytëzim, marrëveshjet për të mos i futur në punë anijet, që njihen si “kufizimet e kapacitetit”;
- Marrëveshjet për të mos hapur shërbime konkurruese ose për të tërhequr shërbimet konkurruese, ose marrëveshjet për të mos i afuar klientëve të konkurrentëve, që njihen si “ndarja e tregut”.

Shkëmbimi me konkurrentët i informacioneve delikate tregtare, për shembull, çmimet, shpenzimet, hedhjet në treg të produkteve ose planet e biznesit, vëllimet, të dhënat e ndarjes së tregut, është i paligjshëm dhe ndalohet rreptësisht. Kini parasysh se edhe lajmërimet publike për rritjet e ardhshme të çmimeve (“sinjalizimi”) nëpërmjet faqeve të internetit ose komunikatave të shtypit mund të konsiderohen si antikonkurruese.

Shkelja e Ligjeve për Mbrojtjen e Konkurrencës mund të lindë edhe nga abuzimi me pozitën dominuese. Një pozicion dominues është i ligjshëm dhe ekziston kur një kompani ka një prani kaq të madhe në treg sa që mund të sillt në mënyrë të pavarur nga konkurrentët dhe klientët. Abuzimi me pozitën dominuese është i paligjshëm dhe shkaktohet nga përdorimi i këtij pozicioni për të shfrytëzuar klientët ose për të përjashtuar konkurrentët. Në shumicën e tregjeve, MSC-ja përballet me konkurrencë të mjaftueshme kështu që nuk lindin probleme të tilla, por duhet pasur kujdes në ato tregje ku MSC-ja zotëron një pjesë të madhe të tregut. Për shembull, sipas ligjit të Bashkimit Evropian, ka shumë pak mundësi që një kompani të konsiderohet si dominuese nëse pjesa e saj në treg është më pak se 40%.

Shënim: megjithëse mund të vlejnjë rregulla të veçanta lidhur me shoqëritë ose shoqatat, përfshi marrëveshjet për diskutim të vullnetshëm, përsëri duhet të garantoni pajtueshmëri të plotë me Ligjet për Mbrojtjen e Konkurrencës. Për udhëzime të mëtejshme mbi këtë çështje, kontaktoni me Ekipin e Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë.



DOKUMENTET FINANCIARE DHE TË BIZNESIT

Saktësia dhe ruajtja e dokumenteve financiare dhe të biznesit të MSC-së është vendimtare dhe duhet të garantohet.

Në këtë aspekt, të gjithë Punonjësit duhet:

- Të regjistrojnë dhe të klasifikojnë gjithmonë transaksionet në periudhën e duhur kontabël dhe në llogarinë dhe departamentin përkatës;
- Të mos shtrembërojnë natyrën e vërtetë të asnjë transaksioni;
- Të mos falsifikojnë asnjë dokument;
- Të mos mundësojnë përpjekjet e një personi tjetër për t'iu shmangur tatimeve, për të pastruar para ose për të shkelur ligje të tjera;
- Të provojnë gjithmonë vlerësimet dhe detyrimet e përlogaritura me dokumentacionin e përkatës;
- T'i mbajnë dokumentet për periudhën minimale kohore prej 10 (dhjetë) vjetësh ose më shumë nëse kërkohet sipas ligjit lokal;
- T'i mbajnë dokumentet e kërkuara dhe të mos asgjësojnë, ndryshojnë, fshijnë ose shkatërrojnë asnjë informacion ose dokument që mund të ketë lidhje me një hetim dhe/ose mund të jetë objekt i ruajtjes së dokumentacionit për çështje gjyqësore.

KONTRATAT

Çdo Punonjës duhet të marrë të gjitha miratimet e duhura para se të nënshkruajë, modifikojë, ndryshojë ndonjë kontratë.

Për qëllimin e këtij paragrafi, "kontrata" përfshin, pa kufizim, kontratat e transportit, kontratat e terminalit, marrëveshjet për ndarjen e anijes, marrëveshjet për transportuesit ndërlidhës, marrëveshjet e agjencive dhe marrëveshjet për furnizimet me rezervuarë lëndësh djegëse. Nëse Punonjësit kanë ndonjë pyetje ose u duhet ndonjë këshillë për ndonjë kontratë, duhet të mbajnë lidhje me Ekipin e Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë.



INFORMACIONET KONFIDENCIALE, MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE PRIVATËSIA, DHE PAJISJET ELEKTRONIKE

INFORMACIONI KONFIDENCIAL

Punonjësit duhet të mbrojnë të gjithë Informacionin e tyre Konfidencial, si dhe çdo Informacion Konfidencial që marrin nga klientët dhe furnitorët e MSC-së ose të Agjencive dhe nga çdo palë tjetër e tretë.

Mospërbushja e këtij detyrimi mund të shkaktojë shkeljen e detyrimeve që lindin nga kontratat ose ligjet për mbrojtjen e sekreteve tregtare, mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë.

Informacioni Konfidencial nuk duhet t'i raportohet në asnjë rast asnjë personi jashtë MSC-së dhe Agjencive, përfshi familjarët dhe shokët, përveçse nëse kërkohet me ligj.

Informacioni Konfidencial nuk duhet të ndahet me persona të tjerë brenda MSC-së ose Agjencive, përveçse në rastet e "nevojshme për t'i ditur". Të gjithë Punonjësit janë të detyruar të mbrojnë informacionet konfidenciale, edhe pasi të mbarojë punësimi ose biznesi.

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE PRIVATËSIA

MSC-ja respekton dhe mbron privatësinë e Punonjësve, klientëve dhe partnerëve të saj të biznesit, duke i përpunuar të dhënat personale në përputhje me kërkesat e vendosura nga ligjet dhe rregulloret në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Ajo garanton veçanërisht efikasitetin e të drejtave të mbrojtjes së të dhënave të personave për të cilët përpunohen të Dhënat Personale.

Të Dhënat Personale do të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dhe për qëllime të specifikuar dhe legjitime. MSC-ja ka miratuar masat e duhura teknike dhe organizative të sigurisë për të mbrojtur të Dhënat Personale që përpunon dhe ruan dhe merr masa paraprake për të parandaluar përhapjen e paautorizuar.

MSC-ja ndërgjegjëson vazhdimisht Punonjësit e saj për çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave.

Punonjësit duhet të jenë të ndërgjegjësuar për detyrat e tyre lidhur me të Dhënat Personale dhe konfidencialitetin dhe duhet të respektojnë programin e MSC-së për pajtueshmërinë me mbrojtjen e të dhënave, udhëzimet e Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë dhe të nëpunësve të MSC-së për mbrojtjen e të dhënave, përfshi, por jo vetëm, në lidhje me mbledhjen, përdorimin dhe menaxhimin e të Dhënave Personale. Agjencitë ose Punonjësit që vihen në dijeni të një shkeljeje të rregullave të Mbrojtjes së të Dhënave duhet ta raportojnë menjëherë tek Ekipi i Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë.

PAJISJET ELEKTRONIKE

MSC-ja dhe Agjencitë mund t'u japin Punonjësve të tyre Pajisje Elektronike për qëllime profesionale. Punonjësit duhet t'i përdorin këto pajisje vetëm për qëllimin e tyre të caktuar dhe do të kufizohen që të mos i përdorin për qëllime personale. Pajisjet Elektronike duhet të përdoren në përputhje me politikën e MSC-së dhe të Agjencive dhe me udhëzimet e Ekipit të Pajtueshmërisë Ligjore të Korporatës MSC në Gjenevë.

MSC-ja ose Agjencitë kanë të drejtë të monitorojnë herë pas here përdorimin e Pajisjeve Elektronike brenda parashikimeve të ligjit, ku përfshihet çdo e dhënë, Informacion Konfidencial dhe e Dhënë Personale e ruajtur në këto pajisje.

MEDIAT SOCIALE DHE LIGJËRIMI PUBLIK

PËRDORIMI I MEDIAVE SOCIALE PËR BIZNES

MSC-ja i inkurajon të gjithë Punonjësit të marrin pjesë në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale në Mediat Sociale të MSC-së si mjet për të ngjallur interes për shërbimet e MSC-së dhe për të krijuar mundësi biznesi. MSC-ja i inkurajon Punonjësit të përdorin faqet zyrtare të MSC-së në Mediat Sociale. Çdo Punonjës mund të ndajë dhe të komentojë për çdo postim që bëhet në faqet zyrtare të MSC-së në Mediat Sociale.

Nëse një Punonjës, për shkak të detyrave të punës, nevojitet të flasë në emër të MSC-së në mjedisin e mediave sociale, ai duhet të kërkojë miratim për përmbajtjet e këtyre komunikimeve nga Departamenti i Marketingut Botëror i MSC-së në Gjenevë (i cili mund të kontaktohet në adresën social@msc.com). Në rastet kur do të bëhet shpesh, Punonjësit në fjalë mund t'i kërkojë të kryejë trajnim ose të marrë këshilla mbi Mediat Sociale për qëllime biznesi. Punonjësi nuk duhet të përgjigjet vetë pa miratim paraprak me shkrim për ta bërë këtë.

Gjatë përdorimit të Mediave Sociale të MSC-së, Punonjësit nuk duhet të postojnë ose të shprehin pikëpamje mbi postimin e një personi tjetër, të tilla si "pëlqimi" i një postimi në Facebook, për çdo gjë që MSC-ja ose partnerët e biznesit të MSC-së mund ta konsiderojnë si ofenduese, përfshi racizmin, shpifjet etnike, komentet seksiste, komentet diskriminuese, blasfeminë, gjuhën abuzive ose të turpshme, ose deklaratat e rreme keqdashëse.

Punonjësit që kanë pyetje rreth përgjegjësisë të tyre lidhur me përdorimin e Mediave Sociale duhet të shikojnë Politikën e Mediave Sociale të publikuar në intranetin e MSC-së ose të kontaktojnë në adresën social@msc.com.

LIGJËRIMI PUBLIK DHE ANGAZHIMI NË MEDIA

MSC-ja e pranon që Punonjësit mund të dëshirojnë herë pas here të marrin pjesë në evenimente të ligjërimit publik ose të flasin me gazetarët dhe se këto aktivitete mund të ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve me palët e jashtme dhe në promovimin e MSC-së dhe shërbimeve të saj. Edhe mbajtja e një fjalimi në një konferencë ose dhënia e një interviste në media përfshihen në aftësitë që disa Punonjës inkurajohen të zhvillojnë.

Çdo fjalim në ngjarje publike ku një Punonjës identifikohet si MSC-ja dhe çdo koment në media mund të interpretohet si përfaqësim i MSC-së. Prandaj, MSC-ja duhet të garantojë që në publik të përhapen vetëm informacionet e duhura dhe që këto përfaqësime të bëhen në përputhje me Politikën e MSC-së, me një standard në të mirë të markës së MSC-së dhe në një mënyrë të koordinuar në të gjithë aktivitetin tonë botëror.

Prandaj Punonjësve iu kërkojë të informojnë Departamentin e Komunikimeve të Brendshme dhe të Marrëdhënieve Globale me Publikun të MSC-së në Gjenevë për çdo mundësi të ligjërimit në publik ose angazhimit në media para se ta pranojnë. Këto kërkesa rishikohen dhe, ose miratohen, ose kërkojnë informacione të mëtejshme ose refuzohen. Në disa raste, kërkojë kontrollimi i fakteve ose trajnimi dhe përgatitja para se të jepet drita jeshile për të vazhduar.

Ashtu si shumë organizata të tjera të mëdha, MSC-ja drejton një zyrë shtypi, nëpërmjet së cilës MSC-ja ndërvepron me mediat nëpërmjet individëve që kanë eksperiencë për të kuptuar interesat dhe nevojat e gazetarëve. Punonjësit që angazhohen papritur nga gazetarët ose që mendojnë në mënyrë proaktive të angazhohen me mediat, mund të kontaktojnë me Departamentin e Komunikimeve të Brendshme dhe të Marrëdhënieve Globale me Publikun të MSC-së në Gjenevë ose të dërgojnë një email në adresën media@msc.com.

Punonjësit mund të qasen në politikat e plota për ligjërimit në publik dhe angazhimin me median nëpërmjet intranetit të MSC-së.



MOVING THE WORLD, TOGETHER.

[msc.com](https://www.msc.com)